

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Kontabiliteti Menaxherial  
Zgjidhjet

**P2**

Data 26.01.2019

## PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</b>
1. Problemi 1	25	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	15	
5. Problem 5	20	
<b>Total</b>	<b>100</b>	

## Problemi 1

1. ( 25 pikë)

- a. Koka Co. operon në procesin e prodhimit të kostove dhe pret që humbja normale të jetë 5% e njësive hyrëse. Të gjitha humbjet kanë një vlerë si mbeturina prej 4€ për kg dhe nuk kemi stoqe në fillim dhe në fund të punës në proces në periudhë.

Detalet e mëposhtëm janë dhënë:

Hyrjet e Materialit	5,000 kg
Kostoja e Materialit	€85,000
Puna Direkte	€20,500
Njësit dalës aktuale	4,600 kg

a1. Kalkuloni vlerën e njësive dalëse në periudhë? (5 pikë)

a2. Kalkuloni vlerën monetare të pranuar nga mbeturinat e materialit për periudhën? (3 pikë)

- b. Lisi Co. dëshiron të sigurohet se kostot e stoqeve janë duke u menaxhuar mirë dhe të jenë minimale. Kemi informatat në vijim të ndërlidhura me lëndën e parë në përdorim vjetor prej 8,000 njësi:

Çmimi i blerjes është €25 për njësi.

Secila porosi kërkon €12 kosto administrative dhe plus €100 për ngarkesën e shpërndarjes. Shpenzimet e magazinimit përbëhen nga pjesa fikse prej 40 cent (0.4€) për njësi në vite dhe kostot variabile prej 5% e çmimit të blerjes për njësi në vite.

Kalkuloni ri porositjen optimale(ekonomike) në sasi (rrumbullakosni vlerat. (5 pikë)

- c. Co Co. prodhon një seri të produkteve të ndryshme duke përdorur punëtor profesional në procesin e prodhimit. Kemi në dispozicion informatat e mëposhtme dhe dëshirojmë të përcaktojmë koeficientin e paracaktuar më të përafërt për absorbimin e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit (Shpp).

Informatat nga buxheti:

Shp. e përgjithshme të prodhimit fikse	€360,000
Orët e punës	3,600 orë
Orët e makinerisë	20,000 orë
Njësit e prodhimit	1,000 njësi
Kostot aktuale fikse	€260,000

Kalkuloni koeficientin e paracaktuar të përvetësimit të Shp. përgjithshme (4 pikë)

- d. Lo Co. ka buxhetuar shitjet 10,000 njësi për muaj dhe fitim kontributin për njësi €20 euro për njësi. Nëse marxhina e sigurisë është 30%, kalkuloni nivelin e buxhetuar të kostove fikse në periudhën e njëjtë. (3 pikë)

e. Karta e kostos standardë është dhënë më poshtë për periudhën e fundit financiare:

	<b>€ për njësi</b>
Çmimi i shitjes	50
Materiali Direkt	4
Puna Direkte	16
Shpenz. Përgjithshme fikse	5
Shpenz. Përgjithshme variabile	10
Kostot fikse të shitjes	1
<u>Kostot variabile të shitjes</u>	<u>1</u>
Kosto totale	37
Njësit e buxhetuar të shitjes	3,500
Njësit Aktuale të shitjes	3,000

Kalkuloni Variancën e vëllimit të shitjes, sipas trajtimit të absorbimit të kostove. ( 5 pikë)

Zgjidhja 1

1.

a1.

**Gimi Co. -**

			<b>Llogaria e Procesit</b>		
	<b>Kgs</b>	<b>€</b>		<b>Kgs</b>	<b>€</b>
Materialet	5,000	85,000	Nj. Dal. aktuale	4,600	101,200
			H. jo normale	150	3,300
Puna		20,500			
Fitimi jonormal	175	3,675	Humja Norm.	250	1,000
	<u>5,000</u>	<u>105,500</u>		<u>5,000</u>	<u>105,500</u>

$$\text{Kosto për njësi} = \frac{85,000 + 20,500 - 1,000}{5,000 - 250}$$

= €22 për njësi dalëse.

$$\text{a2. Mbeturinat aktuale} = 5,000 - 4,600 = 400 \text{ kg} \times \text{€4} = \text{€1,600.}$$

$$\text{b. Sasia e Porosisë Ekonomike} = \sqrt{\frac{2C_0D}{C_H}} = \sqrt{\frac{2 \times 8,000 \times (100 + 12)}{(25 \times 5\%) + 0.40}} = 1,042 \text{ njësi (Rrumbullaksim)}$$

c. Orët e punës janë më të përafërta për përcaktimin e Shk. Paracaktuar të Absorbimit €360,000 / 3,600 orë =€100 për orë pune .

d. Marxhina e siguris prej 30% është e barabart me 3,000 njësi në muaj. Pika e Rentabilitetit është 7,000 njësi (10,000 - 3,000). Pasi që fitimi kontributi është i barabart me kostot fikse (20 x 7,000) , kostot fikse do të jenë €140,000.

e.

	<b>€ për njësi</b>
Çmimi i shitjes	50
Materiali Direkt	4
Puna Direkte	16
Sh.p.p. Variable	10
Shp. E pergjith. Fikse	5
<u>Total kostot e prodhimit</u>	<u>35</u>
Fitim Bruto	15
Varianca në njësi (3,000 - 3,500)	500 PaFav
Varianca e vëllimit të shitjeve	€7,500 PaFav

## Problemi 2

Lodra Co. prodhon vetëm një produkt GAME që përdoret ekskluzivisht për industrinë e prodhimit të lodrave. Kompania është duke projektuar planet për periudhën e ardhëshme financiare: për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2018.

Drejtorët janë të shqetësuar për të siguruar profitabilitetin dhe vazhdimësin dhe kanë një numër të pyetjeve dhe propozimeve për të cilat ata kërkojnë këshilla.

Informacioni i mëposhtëm është ofruar për Lodra Co , për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2018:

- 42,000 njësi të produktit pritet të jenë shitjet me një çmim të shitjes prej 25 € për njësi.
- Kostot e prodhimit janë të buxhetuara në 612,000 € nga të cilat 75,000 € konsiderohen si kosto fikse.
- Shpenzimet e shitjes dhe shpërndarjes janë të buxhetuara në 175,000 € prej të cilave kostot variabile konsiderohen 8% e shitjeve.
- Shpenzimet e administratës janë të buxhetuara në € 48,000 kosto fikse plus 9,000 € variabile duke i dhënë një total prej 57,000 €.

### KËRKOHET:

- (a) Kalkuloni Pikën e Rentabilitetit në njësi dhe Marxhinën e Sigurisë bazuar në buxhetin original në të dhënat e mësipërme. (5 pikë)
- (b) Jepni një sqarim të shkurtër për “Marxhinën e Sigurisë”. (1 pikë)
- (c) Kalkuloni ndikimin e pritur në fitim, nëse kërkesa për shitjet rritet për 10%. ( 3 pikë)
- (d) Lodra Co. është duke e shqyrtuar fushatën e re të marketingut, që Lodrat ju ofron klientëve në shtëpi, që ka për qëllim të zvogëloj distancën me klientin në përgjithësi. Kostot e ndërlidhura me fushatën e re vlerësohet të jenë €100,000. Ri kalkuloni pikën e rentabilitetit dhe numrin e njësisive shtesë që duhet të shiten për të mbuluar kostot shtesë. ( 3 pikë)
- (e) Përndryshe kompania është duke marrë parasysh dy opsione të cilat mund të lejojnë atë të përqendrohemi vetëm në industrinë e LODRAVE:

Opsioni A: Ofrimi i një komision të shitjes stafit prej € 2 për njësi.

Opsioni B: Ulja e çmimit aktual të shitjes për € 2 për njësi.

Opsioni A pritet të rritë shitjet me 30% ndërsa Opsioni B do të arrijë një rritje prej 20% të shitjeve. Megjithatë,

Opsioni B do të kërkojë gjithashtu një kosto shtesë fikse për reklamat e € 10,000.

Këshilloje kompaninë se cili opsion do të sigurojë fitim më të lartë dhe mbështeteni përgjigjen tuaj me të përshtatshme me llogaritje. (8 pikë)

[Total: 20 pikë]

## Zgjidhja 2

### Pjesa (a)

<b>Analiza e Kostove</b>	<b>Fikse</b>	<b>Variabile</b>	<b>Total</b>
Kostot e prodhimit	75,000	537,000	612,000
Kostot e shitjes dhe shpërndarjes	91,000	84,000	175,000
<u>Kostot Administrative</u>	<u>48,000</u>	<u>9,000</u>	<u>57,000</u>
	214,000	630,000	844,000

Çmimi i shitjes për njësi			€25
Kostot variabile për njësi		$(630,000/42,000) =$	€15
Fitimi kontributi për njësi			€10
Pika e rentabilitetit në njësi = Kostot fikse =		$€214,000 / 10 =$	21,400 njësi
Kontributi			

Marxhina e Siguris:

Prodhimi i buxhetuar =	42,000 njësi
Pika e Rentabilitetit =	21,400 njësi
Diferenca =	20,600 njësi
Marxhina e Siguris =	20,600 njësi ose $20,600/42,000 = 49.04\%$ (5 pikë)

### Pjesa (b)

#### Sqarim:

Marxhina e Siguris paraqet diferencën në mes njësave në pikën e rentabilitetit dhe kërkesave të tregut për njësi. (1 pikë)

### Pjesa (c)

Një rritje në kërkesën e shitjeve prej 10% do të rritë shitjet në 46,200 njësi nga 42,000 njësi.

Kontributi i pritur	$(46,200 \times €10) =$	€462,000
<u>Kostot Fikse (pa ndryshim) =</u>		<u>€214,000</u>
Fitimi i pritur pas rritjeve të shitjeve		€248,000 (3 pikë)

### Pjesa (d)

Kostot shtesë  $€100,000 / €10$  kontributi = 10,000 njësi kërkohej.  
PE Rent. e vjeter = 21,400 njësi plus njësit shtes 10,000 => Pika e re e Rent.= 31,400 njësi (3 pikë)

### Pjesa (e)

#### Opsioni A (Komisionet e shitjeve):

Rishiqimi i nivelit të shitjes  $(42,000 + 30\%$  shtes) = 54,600 njësi

Rishiqimi i kontributit  $(10 - 2) = €8$  për njësi

Kontributi i pritur  $(54,600 \times 8) = 436,800$

Kostot Fikse (pa ndryshim) = 214,000

Opsioni A, fitimi i pritur €222,800

#### Opsioni B (Ulja e çmimit):

Rishiqimi i nivelit të shitjes  $(42,000 + 20\%$  extra) = 50,400 njësi

Rishiqimi i kontributit  $(10 - 2$  çmimi i ulët) = €8 per njësi

Kontributi i pritur  $(50,400 \times 8) = 403,200$

Kostot Fikse  $(214,000 + 10,000$  reklama) = 224,000

Opsioni B, fitimi i pritur €179,200

#### Rekomandim:

Opsioni A duhet të pranohet pasi që sjell profit më të lartë. (8 pikë)

Total 20 pikë

### Problemi 3 (20 pikë)

Era Co. prodhon shtëpi lodra për kopshte. Menaxhmenti sapo ka pranuar raportin e mëposhtëm për prodhimin për Vitin 2018. Informacionet janë të lidhura me një produkt të vetëm që quhej "Shtëpia e Borbardhës". Kompania aplikon trajtimin marxhinal.

	<b>Standard</b>	<b>Aktual</b>
Shitjet (njësi)	22,400	24,200
Çmimi i shitjes (njësi)	€1,200	€1,100
Lënda e parë e përdorur	672,000 kg	701,800 kg
Kostoja e lëndës së pare	€10 për kg	€11 për kg
Koha e punës	448,000 orë	459,800 orë
Shkalla e pagesës	€20 për orë	€21 për orë
Shpenz. Përgjithshme variabile	Bazuar në 50%	Kostot Aktuale
	E kostove të punës	€4,250,000
Shpenz. Përgj. Fikse	€4,032,000	€3,900,000

#### KËRKOHET:

- Përgatiteni një pasqyrë të fitimit të buxhetor për Vitin 2018. (3 pikë)
- Përgatiteni një pasqyrë të fitimit aktual për Vitin 2018. (3 pikë)
- Përgatiteni një pasqyrë të konsoliduar të fitimit të buxhetuar dhe atij aktual dhe kalkuloni të gjitha variancat e mundshme nga informacionet. (14 pikë)

**[Total: 20 pikë]**

### Zgjidhja 3

#### Pjesa (a)

#### Pasqyra e Fitimit të buxhetuar për vitin 2018

			<b>Buxhetimi €</b>
Shitjet	(22,400 × 1,200)		26,880,000
Zbritur:			
Materiali direkt	(672,000 × 10)	6,720,000	
Puna direkte	(448,000 × 20)	8,960,000	
Sh.p.p. variabile	(8,960,000 × 50%)	4,480,000	
Kostot fikse	(Të dhëna)	4,032,000	
			<u>24,192,000</u>
Fitimi i buxhetuar			2,688,000 (3 pikë)



**Pjesa (b)**  
**Pasqyra e Fitimit Aktual për vitin 2018**

			<b>Aktual €</b>
Shitjet	(24,200 x 1,100)		26,620,000
Zbritur:			
Materiali Direkt	(701,800 x 11)	7,719,800	
Puna Direkte	(459,800 x 21)	9,655,800	
Sh.p. Variable	(Të Dhëna)	4,250,000	
Kostot Fikse	(Të Dhëna)	3,900,000	
			<u>25,525,600</u>
Fitimi Aktual (3 pikë)			1,094,400

**Pjesa (c)**

**Puna:**

<b>Çmimi I shitjes:</b>	Shitjet e bëra (24,200 x 1,100)	26,620,000
	<u>Shitjet e pritura (24,200 x 1,200)</u>	<u>29,040,000</u>
		<b>2,420,000 (PF)</b>

Varianca e vëllimit të shitjes

$$MS = 1,200 - 300 - 400 - 200 = 300$$

$$\text{Varianca e vëllimit} = (24,200 - 22,400) \times 300 = \mathbf{540,000 (F)}$$

<b>Çmimi i matritialit:</b>	Kostot e bëra (701,800 x 11)	7,719,800
	<u>Shitjet e pritura (701,800 x 10)</u>	<u>7,018,000</u>
		<b>701,800 (PF)</b>

<b>Përdorimi i materialit:</b>	Përdorimi i bërë	701,800 kg
	Përdorimi i pritur 24,200 x 30	726,000 kg
		24,200 kg
		<u>x 10</u>
		<b>242,000 (F)</b>

<b>Çmimi i punës:</b>	Pagesat e bëra	9,655,800
	<u>Pagesat e pritura (459,800 x 20)</u>	<u>9,196,000</u>
		<b>459,800 (PF)</b>

<b>Efikasiteti i punës:</b>	Koha e kaluar	459,800 orë
	Koha e pritur (24,200 x 20)	484,000 orë
		24,200 orë
		<u>x 20</u>
		<b>484,000 (F)</b>

<b>Sh.p. Variable :</b>	Kostot e bëra	4,250,000
<u>Kostot e pritura</u>	<u>(459,800 x 20 x 50%)</u>	<u>4,598,000</u>
		<b>348,000 (F)</b>

<b>Efikasiteti I sh.p.p. variable:</b>	Kostot e bëra	459,800 orë
	Pritura	484,000 orë
		24,200 orë
		<u>x 10</u>
		<b>242,000 (F)</b>

<b>Sh.p. Fikse</b>	Kostot e bëra	3,900,000
	Pritura	4,032,000
		<b>132,000 (F)</b>

**Era Co. - Pasqyra e Operacioneve për vitin 2018.**

	<b>PF</b>	<b>Fav</b>	<b>Total</b>
Fitimi i buxhetuar për periudhën			2,688,000
<b>Variancat:</b>			
Çmimi i shitjes	2,420,000		
Vëllimit të shitjes		540,000	
Çmimi i materialit	701,800		
Përdorimi i materialit		242,200	
Çmimi i punës	459,800		
Çmimi i efikasitetit		484,000	
Çmimi i sh.p.p. variable		348,000	
Efikasiteti i sh.p.p. variable		242,000	
Sh.p.p. Fikse		132,000	
	<u>3,581,600</u>	<u>1,988,000</u>	<u>(1,593,600)</u>
Fitimi Aktual (14 pikë)			1,094,400
<b>[Total: 20 pikë]</b>			

#### Problemi 4 (15 pikë)

Kyli Co. ka filluar prodhimin komercial për produktin e saj të vetëm për herë të parë me 01 Janar 2018, duke filluar edhe shitjen e tij njëkohësisht. Informatat e mëposhtëm janë selektuara nga Kontabiliteti Menaxherial nga buxheti origjinal të përgatitura për kuartalin e parë të vitit:

Materiali Direkt për njësi 10 kg @ €4 për kg  
Puna Direkte për njësi 3 orë @ €15 për orë  
Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit variabile €24,000 për muaj  
Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit fikse €28,800 për muaj  
Çdo njësi është shitur me çmimin fiks për €138.

Të gjitha shpenzimet e përgjithshme të prodhimit janë absorbuar në njësi të produkteve nga Kontabiliteti Menaxherial duke u bazuar në prodhimin e buxhetuar prej 1,600 njësi në muaj.

Për muajt, Janar, Shkurt dhe Mars, të dhënat e mëposhtëm janë mbledhur:

	<b>Janar</b>	<b>Shkurt</b>	<b>Mars</b>
Njësitë e prodhuara	1,500	1,300	1,100
Njësitë e shitura	1,200	1,400	1,300

Ju mund të vlerësoni që shpenzimet e përgjithshme të prodhimit krijohen gjatë tërë vitit dhe nuk mund të kemi diferenca në mes të kostove të buxhetuara dhe aktuale gjatë kuartalit në rishikim. Pasi që kompania ka vetëm një produkt komercial, Kontabilisti Menaxherial është i pasigurt se cilën metodë për kostot e kompanisë të adaptoi për raportimin e mbrëmshëm në kuartal tekë drejtorët. Ai ju kërkon ju të përgatisni informatat e mëposhtme për takimin e Bordit që po vjen.

#### Kërkohet:

- Kalkuloni koston për njësi të produktit duke përdorur të dy metodat, të absorbimit dhe marxhinale të kostove. ( 4 pikë )
- Përgatisni pasqyrën e operacioneve për muajt Janar, Shkurt dhe Mars duke përdorur metodën e absorbimit dhe marxhinale të kostove.

(11 pikë)

**[Total: 15 pikë]**

#### Zgjidhja 4

Pjesa (a)

Kosto për njësi e produktit (€):

		<b>Absorbimi</b>	<b>Marxhinal</b>
Materialet direkt për njësi	10 kg @ €4 për kg	40	40
Puna direkte për njësi	3 orë @ €15 për orë	45	45
Sh.p.p. variabile	€24,000/1,600 njësi	15	15
Sh.p.p. fikse	€28,800 /1,600 njësi	18	N/A
		118	100

#### (4 pikë)

Pjesa (b)

Pasqyra e Operacioneve - Metoda e Absorbimit të Kostove

	<b>Januar</b>	<b>Shkurt</b>	<b>Mars</b>
Shitjet	165,600	193,200	179,400
Kostot e shitjes - produkteve			
Stoqet në hapje	-	35,400	23,600
Kostot e prodhimit (W1)	177,000	153,400	129,800
Stoqet në mbyllje (W2)	(35,400)	(23,600)	(0)
	141,600	165,200	153,400
Shitjet zbritur nga Kostot e shitjes (Nën) / Mbi Aplikim (W3)	24,000	28,000	26,000
	(1,800)	(5,400)	(9,000)
Fitimi	6,400	13,760	17,060

Pasqyra e Operacioneve - Metoda Marxhinale e Kostove

	<b>Januar</b>	<b>Shkurt</b>	<b>Mars</b>
Shitjet	165,600	193,200	179,400
Kostot e shitjes - produkteve			
Stoqet në hapje	-	30,000	10,640
Kostot e prodhimit (P1)	150,000	130,000	110,000
Stoqet në mbyllje (P2)	(30,000)	(20,000)	(0)
	120,000	140,000	130,000
Fitim Kontributi	45,600	53,200	49,400
Zbriten Kostot Fikse	(28,800)	(28,800)	(28,800)
Fitimi	16,800	24,400	20,600

#### Zgjidhjet e sygjera

##### Puna 1: Kostot e prodhimit

	<b>Njësit Aktuale</b>	<b>Absorbimi</b>	<b>Marxhinal</b>
		<b>(€118 për njësi)</b>	<b>(€100 për njësi)</b>
Prodhimi - Jan	1,500	177,000	150,000
- Shku	1,300	153,400	130,000
- Mar	1,100	129,800	110,000

**Puna 2: Stoqet në mbyllje**

	<b>Januar</b>	<b>Shkurt</b>	<b>Mars</b>
Stoku në hapje	-	300	200
Njësit e prodhuara	1,500	1,300	1,100
	1,500	1,600	1,300
Njësit e shitura	1,200	1,400	1,300
Stoku në mbyllje	300	200	0
Kostot e Absorbimit €118	35,400	23,600	0
Kostot Marxhinale €100	30,000	20,000	0

**Puna 3: Nën / Mbi Aplikimi**

	<b>Januar</b>	<b>Shkurt</b>	<b>Mars</b>
Prodhimi i pritur	1600	1600	1600
Prodhimi Aktual	1500	1300	1100
Ndryshimi (+ / -)	-100	-300	-500
Shkalla e absorb, kostove fikse	€18	€18	€18
(Nën) / Mbi Aplikimi	(1,800)	(5,400)	(9,000)
<b>(11 pikë)</b>			

**[Total : 15 pikë]**

### Problemi 5 (20 pikë)

Një prodhues i Llambave është duke përgatitur buxhetin dhe na jepe figurën e draft buxhetit si më poshtë:

Shitjet e buxhetuara (njësi)	
Janar	10,000
Shkurt	8,000
Mars	7,000
Prill	9,000
Maj	11,000

Çmimi standard i shitjeve për njësi është €150.

Secila dritë elektrike përdorë 4kg të telit me kosto prej €30 për kg dhe politika e kompanisë është të mbaj stoqe të lëndës së parë në fund 40% e të kërkesave për prodhim të muajit tjetër. Pritet që stoku në hapje në Janar të jetë 2,900 kg tel.

Në fillim të Janarit pritet të jenë 1,000 njësi të Llambave në stok dhe politika e kompanisë është që stoku në fund të muajit të mbuloj 20% e shitjeve të muajit në vijim.

#### Kërkohe

(a) Përgatiteni buxhetin e prodhimit për katër muajt e parë të vitit. (8 pikë)

(b) Përgatiteni buxhetin e blerjeve dhe përdorimit të lëndës së parë për tre muajt e parë të vitit. (12 pikë)

[Total: 20 pikë]

## Zgjidhja 5

Pjesa (a) – Buxheti i prodhimit (në njësi) për katër muaj të vitit.

	<b>Jan</b>	<b>Shku</b>	<b>Mar</b>	<b>Prill</b>
Shitjet	10,000	8,000	7,000	9,000
Stoqet në fund	1,600	1,400	1,800	2,200
Stoqet në fillim	(1,000)	(1,600)	(1,400)	(1,800)
Prodhimi	10,600	7,800	7,400	9,400

**(8 pikë)**

Pjesa (b) – Përdorimi i materialit dhe blerjet e buxhetuara për tre muajt e parë të vitit.

	<b>Jan</b>	<b>Shku</b>	<b>Mar</b>	<b>Prill</b>
Prodhimi	10,600	7,800	7,400	9,400
	x 4 kg	x 4 kg	x 4 kg	x 4 kg
Përdorimi (kg)	42,400	31,200	29,600	37,600
Stoku në fund	12,480	11,840	15,040	
Stoku në fillim	(2,900)	(12,480)	(11,840)	
Blerjet (kg)	51,980	30,560	32,800	
	x€30	x €30	x €30	
Blerjet (€)	1,559,400	916,800	984,000	

**(12 pikë)**

**[Total : 20 pikë]**